

# Raporti monitorues i keqinformimit për muajin korrik

## 2024

gusht 2024

Action for  
Democratic Society  
[hibrid.info](http://hibrid.info)



# Raporti monitorues i keqinformimit për muajin korrik

**Publikues:** ADS/hibrid.info

Prishtinë, gusht 2024

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit “Promovimi i gazetarisë objektive dhe lufta kundër dezinformimit”, që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NED-it.

Projekti financohet nga:



Projekti realizohet nga:



# Përmbajtja

01.

## Publikimet në gjuhën shqipe

Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

Temat e përdorura për krijimin dhe

shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

Llojet e fushave tematike

Llojet e publikuesve

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën

shqipe dhe serbe

Llojet e mediave sociale

Figurat dhe Institucionet më të përfolura

02.

## Publikimet në gjuhën serbe

Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

Temat e përdorura për krijimin dhe

shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

Llojet e fushave tematike

Llojet e publikuesve

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën

shqipe dhe serbe

Llojet e mediave sociale

Figurat dhe Institucionet më të përfolura

03.

## Kontrulli dhe vlerësimi i deklaratave

# Hyrje

Ky raport përmbledhës dhe përshkrues pasqyron gjendjen e informimit (keqinformimit) gjatë korrik 2024, bazuar në të dhënat e siguruar nga platforma për kontroll të fakteve – [hibrid.info](https://www.hibrid.info). Format i këtij raporti është i pari dhe i vetmi i llojit. Është monitorues dhe paraqet gjendjen për një periudhë njëmuajore, ndërsa ky është raporti i 24-të mujor i publikuar deri më tash.

Ky raport është i ideuar nga platforma [hibrid.info](https://www.hibrid.info) e specializuar në kontroll të fakteve, edukim digjital dhe medial, pjesë e OJQ-së kosovare “Action for Democratic Society” (ADS) dhe mbështetet nga fondacioni amerikan “National Endowment for Democracy” (NED) në kuadër të projektit “Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës”.

Në këtë raport monitorues jepet një pasqyrë për formën e përmbajtjeve me karakter informues për dhe rreth ngjarjeve në Kosovë. Në vazhden e këtij raporti paraqiten disa figura (grafika) të dala nga baza e të dhënave të [hibrid.info](https://www.hibrid.info) e ndarë përmes disa kategorive të vlerësimit që janë pjesë e metodologjisë për kontroll të fakteve të kësaj platforme.

Raporti trajton 8 kategori krahasuese të të dhënave, duke synuar të japë një sqarim më objektiv të gjendjes së informimit dhe për të shpjeguar tendencat e keqinformimit për këtë periudhë monitoruese.

Kategoritë monitoruese janë:


- Vlerësimet e artikujve keqinformues;
- Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese;
- Fushat mbi të cilat janë krijuar dhe shpërndarë artikujt keqinformues;
- Llojet e mediave që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Kategorizimi i mediave në gjuhën shqipe dhe serbe që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e mediave sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e publikuesve në mediat sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Institucionet dhe personat e përfolur në artikujt keqinformues;
- Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave.

Përmbajtja e trajtuar nga hulumtuesit e [hibrid.info](https://www.hibrid.info), e që ka shërbyer për ndërtimin e këtij raporti, është kryesisht ajo e publikuar në gjuhën shqipe dhe serbe.

# Klasifikimi i publikimeve në gjuhën shqipe dhe serbe (të tjera)

Kjo matje tregon se në cilën gjuhë janë publikuar artikujt keqinformues të monitoruar gjatë periudhës njëmuajore, duke i kategorizuar mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhë të tjera në lidhje me raportimet e tyre për dhe rreth zhvillimeve në Kosovë.

## PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE



Mostra e monitorimit dhe trajtimit të përmbajtjeve keqinformuese nga platforma “hibrid.info” fokusohet në keqinformimet në gjuhën shqipe, të publikuara në media, portale të dyshimta, si dhe faqe dhe llogari në mediat sociale. Si rezultat, gjatë muajit maj 2024, publikimet në këtë gjuhë përbënin 71% të rasteve të trajtuara.

Gjatë këtij muaji, në kuadër të monitorimit, janë trajtuar 69 përmbajtje, ku 71% përqind kanë qenë në gjuhën shqipe, ndërsa 25 % në gjuhën serbe.

# 1

## Publikimet në gjuhën shqipe

Sipas analizës së 69 përmbajtjeve keqinformuese, rezulton se 49 prej tyre, që përbëjnë 71% të totalit, ishin në gjuhën shqipe. Nga këto përmbajtje, gati gjysma (46%) janë shpërndarë përmes platformave të mediave sociale, ndërsa 21% e tyre janë publikuar në media tradicionale, ndërsa pjesa tjetër është shpërndarë përmes SMS dhe email-it, me nga 1% për secilin kanal. Në mediat sociale, llojet kryesore të keqinformimit ishin mashtrimet (14%), dezinformatat (9%), teoritë konspirative (6%) dhe lajmet e rreme (6%).

Në mediat tradicionale, përmbajtjet keqinformuese ishin më së shumti të llojit 'clickbait', që përbënin 14% të të gjitha rasteve të trajtuara. Fushat më të prekura nga keqinformimi ishin temat sociale (26%), politika (20%) dhe siguria (13%). Sa i përket temave specifike, rasti i Faton Hajrimit ishte në fokus të 7% të përmbajtjeve, ndërsa zgjedhjet u trajtuan në 6% të rasteve dhe ngjarjet tragjike përbënin 4% të totalit të përmbajtjeve keqinformuese gjatë muajit korrik.

Përqindja e përmbajtjeve në  
gjuhën shqipe




# Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

1.1

## KATEGORITË KRYESORE


Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas kategorive vlerësuese



Në bazë të gjetjeve dhe trajtimit të 49 përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe gjatë muajit korrik 2024, është evidentuar se artikujt clickbait janë ato që kanë dominuar si kategori kryesore e keqinformimit me 19%. Kjo kategori pasohet nga përmbajtjet e mashtruese me 17%, dezinformatat me 9%, teoritë konspirative me 6%, lajmet e rreme me 6% dhe përmbajtjet e paverifikuara më 3%.

Gjatë korrikut 2024, është vërejtur se artikujt clickbait kanë përbërë 19% të totalit, duke dominuar si forma kryesore e keqinformimit. Këto artikuj sensationalistë janë veçanërisht të përhapur në media, ku përdoren për të tërhequr lexuesit me tituj tërheqës, por shpesh mashtrues. Përmbajtjet mashtruese, që përbëjnë 17%, tregojnë për praninë e gjerë të mashtrimeve në platformat e mediave sociale. Këto dy kategori janë më të përhapurat dhe tregojnë për rrezikun e përhapjes së informacioneve të pasakta dhe sfidën që përballon audiencia për të dalluar informacionin e saktë nga ai i rremë.

Përveç clickbait-it dhe përmbajtjeve mashtruese, dezinformatat përbëjnë 9% të rasteve të analizuar, ndërsa teoritë konspirative dhe lajmet e rreme përfaqësojnë nga 6% secila. Këto kategori shpesh përhapen në mënyrë të qëllimshme, duke synuar të shkaktojnë konfuzion dhe të deformojnë të vërtetën. Përmbajtjet e paverifikuara me 3% shtojnë sfidën, duke treguar se një përqindje e vogël e përmbajtjeve të pasigurta, megjithëse në numër të vogël, mund të ketë ndikim të konsiderueshëm.



36% e artikujve keqinformues të trajtuar kanë marrë vlerësimin “clickbait” dhe “mashttrim”.



# 1.1.1.

## Analizë e llojeve të vlerësimeve

### 01. Clickbait

Pothuajse të gjithë artikujt e vlerësuar si clickbait janë publikuar kryesisht në mediat reale (14%), të ndjekura nga mediat sociale (4%). Shumica e këtyre artikujve i përkasin fushës së politikës (9%) dhe kronikës së zezë (6%). Në politikë, temat e përmendura më shpesh përfshinin pretendimet se ish-presidenti i SHBA-së, Donald Trump, ka folur për Kosovën, se kandidatja për presidente Kamala Harris e ka përmendur Kosovën, si dhe tema e dialogut Kosovë-Serbi. Ndërkohë, në kronikën e zezë, janë dominuar raste tragjike, ku titujt nuk e bënin të qartë vendndodhjen e ngjarjeve.

### 03. Dezinformatë

Të gjitha dezinformatat janë publikuar në mediat sociale (9%). Fusha e sigurisë ka dominuar me 3% të dezinformatave, e ndjekur nga temat sociale, arsimit, infrastruktura dhe politika, secila me nga 1%. Në fushën e sigurisë, janë publikuar video dezinformuese që lidhen me rastin e Faton Hajrizit, ndërsa në politikë është përhapur dezinformim rreth një sondazhi zgjedhor dhe tema të tjera të ngjashme.

### 02. Mashtrim

Përmbajtjet mashtruese kryesisht janë publikuar në media sociale (14%), përfshirë këtu edhe email (1%) dhe SMS (1%). Dominojnë përmbajtjet mashtruese nga fusha sociale (13%), pasuar nga politika (3%) dhe sporti (1%). Nga fusha sociale u mashtrua lidhur me donacione për shërim, mundësi punë, pensionet, dhënie kredish, kurse falas etj. Ndërsa në fushën e politikës janë publikuar përmbajtje mashtruese ndërlidhur me sondazhe zgjedhore.

### 04. Teori konspirative

Pothuajse të gjitha teoritë konspirative janë publikuar në mediat sociale (6%) dhe në mediat tradicionale (1%). Në mediat sociale janë përhapur teori konspirative kryesisht nga fusha sociale, duke përfshirë tema si tuneli Vatikan-Jerusalem, Nikola Tesla, etj. Ndërkohë, në mediat tradicionale është publikuar një teori konspirative lidhur me një atentat të pretenduar ndaj Donald Trump.

---


Artikuj të tjerë me përmbajtje keqinformuese janë vlerësuar në kategoritë: Lajm i rremë, përmbajtje e paverifikuar, manipulim i fakteve, clickbait/përmbajtje e paverifikuar, satirë, gabim, manipulim i fakteve/dezinformatë, dezinformatë / clickbait

# 1.2

## Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

### KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave



Pas arratisjes së tij më 6 korrik nga burgu, Faton Hajrizi u bë i dyshuar për vrasjen e një zyrtari policor në Serbi më 18 korrik. Gjatë një përpjekjeje për t'u arratisur, ai u vra nga policia, një ngjarje që tërhoqi vëmendjen e madhe të mediave dhe opinionit publik. Këto zhvillime çuan në një rritje të interesit për rastin e tij, duke e bërë atë temë të rëndësishme në shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese. Publikimi i keqinformatave lidhur me rastin e Faton Hajrizit ka bërë që kjo temë të dominojë gjatë muajit korrik në kategorizimin e temave për të cilat u keqinformua.

Publikimi i disa spekulimeve lidhur me zgjedhjet në Kosovë, duke përfshirë edhe sondazhe mashtruese të publikuara në mediat sociale, ka bërë që kjo temë të renditet si e dyta në kategorinë e keqinformimeve të publikuara në gjuhën shqipe gjatë muajit korrik 2024.

Rastet tragjike përbëjnë temën e tretë më të përdorur për publikimin e artikujve me tituj që shpesh nuk e bëjnë të qartë vendndodhjen e ngjarjeve të tilla. Këto artikuj, ndonëse trajtojnë ngjarje tragjike, ato nuk japin informacion të detajuar në tituj mbi lokacionin e saktë të rasteve tragjike, gjë që mund të krijojë konfuzion dhe keqkuptime te lexuesit.

Temat e tjera për të cilat është përhapur keqinformimi gjatë korrikut përfshijnë spekulimet se Donald Trump ka folur për Kosovën, teoritë konspirative lidhur me një tentativë atentati ndaj tij, si dhe informacionet rreth pagës mesatare.



24% e temave kryesore janë për rastin e Faton Hajrizit, zgjedhje në Kosovë, raste tragjike, Trump dhe Kosova, atentati ndaj Trump dhe paga mesatare

# Analizë e kontrolleve të fakteve sipas temave

## 1.2.1.

Në vijim analizohen, në formë të përmbledhur, katër temat kryesore të trajtuara nga media dhe publikues të ndryshëm, sipas matjeve të platformës hybrid.info, përmes metodologjisë së kontrollit të fakteve.

### 01. Rasti i Faton Hajrizit

Të gjitha përmbajtjet keqinformuese lidhur me këtë temë janë publikuar nga faqe dhe llogari në mediat sociale dhe përfshinin përmbajtje nga fusha e sigurisë. Keqinformimet lidhur me rastin e Faton Hajrizit janë klasifikuar si dezinformata (3%), lajme të rreme, satirë dhe dezinformata/clickbait, me nga 1% secila. Në lidhje me këtë temë, janë publikuar gjithashtu video keqinformuese që përmbanin pretendime për vrasjen e tij dhe aksionet policore ndaj tij, duke kontribuar në përhapjen e informacioneve të pasakta.

### 03. Rasti i Faton Hajrizit

Keqinformatat ndërlidhur me raste tragjike (vdekje, vrasje) nga kronika e zezë janë publikuar në media reale dhe media sociale, e të cilat janë vlerësuar si clickbait. Këto përmbajtje edhe pse ndërlidheshin me raste tragjike, në titujt e artikujve nuk bëhej e ditur vendndodhja e ngjarjeve duke lënë hapësirë të keqkuptohet.

### 02. Zgjedhje në Kosovë

Të gjitha përmbajtjet keqinformuese lidhur me këtë temë janë publikuar nga faqe dhe llogari në mediat sociale dhe përfshinin përmbajtje nga fusha e sigurisë. Keqinformimet lidhur me rastin e Faton Hajrizit janë klasifikuar si dezinformata (3%), lajme të rreme, satirë dhe dezinformata/clickbait, me nga 1% secila. Në lidhje me këtë temë, janë publikuar gjithashtu video keqinformuese që përmbanin pretendime për vrasjen e tij dhe aksionet policore ndaj tij, duke kontribuar në përhapjen e informacioneve të pasakta.

### 03. Atentati ndaj Trump

Përmbajtjet keqinformuese lidhur me tentativën për atentat ndaj Donald Trump janë publikuar si në mediat reale ashtu edhe në mediat sociale. Këto keqinformata, që i përkasin fushës së sigurisë, janë klasifikuar si teori konspirative dhe përmbajtje të paverifikuara. Një nga teoritë e publikuara në media sugjeronte se "The Simpsons" e kishin parashikuar atentatin ndaj Trumpit, ndërsa në mediat sociale qarkullonte një fotografi e paverifikuar që supozohej të tregonte një vrimë plumbi pranë gjoksit të tij.


# 1.3

## Llojet e fushave

Si rezultat i gjetjeve të përmbajtjet keqinformuese të trajtuara gjatë muajit qershor del se publikues të ndryshëm (media reale dhe mediat sociale) kanë prodhuar dhe shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese në fushën e politikës.

### FUSHAT KRYESORE

Këtu janë renditur 6-të fushat kryesore




Nga fusha sociale janë publikuar keqinformata lidhur me tema të ndryshme që kanë tërhequr vëmendjen e publikut. Këto përfshijnë informacione të pasakta mbi ofrimin e kredi të lehta, promovimin e kurseve falas që supozohet se ofrojnë mundësi të shkëlqyera për zhvillim personal ose profesional, si dhe shpërndarjen e mundësive të punës që janë në fakt mashtrime. Gjithashtu, janë qarkulluar keqinformata lidhur me braktisjen e fesë islame, duke shpërndarë pretendime të pabaza mbi braktisjen e fesë islame. Për më tepër, janë publikuar informacione të gabuara rreth riimbursimit të faturave elektrike, të cilat janë krijuar për të manipuluar opinionin publik dhe për të nxitur konfuzion.

Fusha e sociale pasohet nga politika, e cila përfshin një gamë të gjerë temash që kanë të bëjnë me zhvillimet aktuale në Kosovë. Një nga temat kryesore është procesi i zgjedhjeve në Kosovë, ku shpeshherë shpërndahen informacione të pasakta dhe spekulime që ndihmojnë në formësimin e opinionit publik. Po ashtu, diskutimet mbi dialogun Kosovë-Serbi janë të pranishme, janë të përmendura edhe deklaratat e presidentit amerikan Joe Biden dhe spekulimet mbi përmendjen e Kosovës nga ana e ish-presidentit Donald Trump.

Siguria është fusha e tretë që përfshin një sërë temash të rëndësishme dhe shpesh të ndërlidhura me zhvillimet aktuale. Një nga temat kryesore është rasti i Faton Hajrizit, i cili ka qenë në qendër të vëmendjes për shkak të arratisjes së tij dhe vrasjes së tij. Një tjetër temë e rëndësishme në fushën e sigurisë është tentimi për atentat ndaj ish-presidentit amerikan Donald Trump.

---



65% e përmbajtjeve keqinformuese të trajtuara janë nga fusha e sociale, politikës, sigurisë dhe kronikës së zezë.


# Llojet e publikuesve

## 1.4

Bazuar në gjetjet dhe analizat e përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe, është e qartë se keqinformimi publik nga faqe dhe llogari në mediat sociale vazhdon të dominojë edhe gjatë muajit korrik. Kjo situatë shqetësuese reflekton trendin në rritje të shpërndarjes së informacionit të pasaktë dhe të manipuluar, i cili shpeshherë përfshin mashtrime, dezinformatat, teori konspirative dhe lajme të rreme.

Ndërsa në mediat reale, është vënë re një prirje në rritje për publikimin e artikujve clickbait, këta të fundit shpesh fokusohen në tema që i takojnë kronikës së zezë, sidomos rasteve tragjike. Artikujt e tillë zakonisht përdorin tituj provokues dhe tërheqës për të kapur vëmendjen e lexuesve, ndonjëherë duke shpërfillur saktësinë e informacionit në titujt që ofrojnë.

DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES  
TË PUBLIKUESVE ME  
PËRMBAJTJE KEQINFORMUESE



68% e artikujve me përmbajtje keqinformuese janë publikuar nga publikuesit në media sociale (46%) dhe në mediat reale (22%).

# Llojet e mediave sociale


## 1.5

Në këtë seksion analizohen vetëm artikujt keqinformues të publikuar dhe shpërndarë nga publikuesit në mediat sociale dhe në këtë rast nuk përfshihen publikimet në mediat tjera (mediat reale dhe portalet e dyshimta).

Në bazë të monitorimit të kryer gjatë muajit korrik, është evidentuar se përmbajtjet keqinformuese në gjuhën shqipe janë shpërndarë në disa platforma të njohura sociale, me Facebook që dominoi me 28% të totalit të publikimeve. Kjo tregon se Facebook vazhdon të jetë një burim kryesor për shpërndarjen e informacionit të pasaktë dhe keqinformimeve, duke ofruar një hapësirë të gjerë për përdoruesit që ndajnë dhe publikojnë përmbajtje të tilla.

Përveç Facebook-ut, TikTok zuri një pjesë më të vogël të publikimeve me 16%, duke reflektuar rritjen e përdorimit të kësaj platforme, sidomos mes të rinjve, për të shpërndarë informacione të ndryshme, përfshirë edhe ato të pasakta. Ndërkohë, Whatsapp dhe Youtube kontribuuan vetëm me 1% secila në shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese, duke treguar se këto platforma janë më pak të përdorura për këtë qëllim krahasuar me Facebook dhe TikTok.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË  
MEDIAT SOCIALE




# Llojet e publikuesve në mediat sociale

## 1.6

Kjo matje, përmes të dhënave monitoruese, analizon ndërveprimin në mediat sociale sa i përket publikimit dhe shpërndarjes së artikujve keqinformues nga publikues të ndryshëm të mediave sociale. Kjo bëhet përmes këtyre kategorive kryesore të publikuesve: faqeve, llogarive, mediave dhe kanaleve që menaxhohen nga përdorues të mediave sociale.

Në bazë përmbajtjet keqinformuese të publikuara në mediat sociale për muajin korrik 2024, më së shumti u publikuan nga faqe (19%) dhe llogari (3%) në Facebook, pasuar nga llogari në TikTok (16%). Përveç këtyre, pati gjithashtu publikime të ndjeshme nga media, të cilat përbënin 6% të totalit, dhe nga grupe të ndryshme në Facebook me 3%. Platforma X kontribuoi me 3% të publikimeve, ndërsa përmbajtjet keqinformuese u evidentuan gjithashtu përmes numrave të telefonit në Whatsapp (1%) dhe kanaleve në YouTube (1%).





# 1.6.1.

## Analiza e llojeve të publikuesve në mediat sociale

Në vijim analizohen këto kategori të mediave sociale në ndërlidhje me publikimet dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

### 01. Facebook

Përmbajtjet mashtruese (7%), dezinformatat (6%) dhe teoritë konspirative (4%) janë tri kategoritë kryesore me të cilat u vlerësuan keqinformatat e publikuara në Facebook. Socialja (13%), siguria (4%) dhe politika (4%) janë tre fushat kryesore, për të cilat u keqinformua gjatë muajit korrik në Facebook. Temat kryesore për të cilat u keqinformuar më së shumti në Facebook janë rasti i Faton Hajrizit dhe publikimet mashtruese për kurse falas, dhënie kredish dhe tema politike.

### 02. TikTok


Mashtrimet (6%) dhe lajmet e rreme (6%) janë kategoritë që kanë dominuar në vlerësimin e përmbajtjeve keqinformuese. Sa i përket fushave, politika (7%) dhe siguria (4%) janë dy fushat për të cilat u keqinformua më së shumti në platformën TikTok. Zgjedhjet në Kosovë dhe rasti i Faton Hajrizit janë dy temat për të cilat u keqinformua më së shumti në TikTok.

# Figurat dhe institucionet më të përfolura

## 1.7.

Kjo matje analizon të dhënat se cilat kanë qenë institucionet dhe personalitetet (figura publike e politike) më të përfolura përmes monitorimit të artikujve me përmbajtje keqinformuese.

### RENDITJA E INSTITUCIONEVE MË TË PËRFOLURA SIPAS PËRQINDJES




Bazuar në 49 përmbajtjet keqinformuese të gjetura dhe trajtuara gjatë muajit korrik 2024, rezulton se në 3 prej tyre janë përmendur 4 institucione të ndryshme.

Komuna e Prishtinës është përmendur në dezinformatën e publikuar në media sociale me pretendimin e ka publikuar listën e fëmijëve të pranuar në institucionet parashkollore.

Nacionale dhe Periskopi u përfolën në artikullin e paverifikuar të publikuar në media me pretendimin se këto dy portale në Kosovë janë në shërbim të regjimit serb. Posta e Kosovës është përmendur në SMS që bën thirrje për të klikuar një vegëz me pretendimin mashtrues se është dërguar nga posta e Kosovës.

## RENDITJA E PERSONAVE MË TË PËRFOLUR SIPAS PËRQINDJES



Donald Trump, Faton Hajrizi dhe Milan Radojčić janë tre nga figurat më të përmendura në përmbajtjet keqinformuese të publikuara në gjuhën shqipe gjatë muajit korrik 2024.

Donald Trump u përfshi në 4 raste keqinformimi, të cilat përfshinin një tentativë atentati ndaj tij dhe teorinë konspirative se ky ngjarje ishte parashikuar nga seriali i animuar “The Simpsons.” Gjithashtu, në disa spekulime u pretendua se Trump kishte bërë deklaratë lidhur me Kosovën.


Faton Hajrizi u përmend në 3 përmbajtje keqinformuese, përfshirë video materiale që përhapnin pretendime të pasakta për aksionet policore për arrestimin e tij dhe momentin e vrasjes së tij nga policia.

Milan Radojčić u përfshi në 2 raste keqinformimi, ku u pretendua pa fakte se i ishte konfiskuar një pompë karburanti dhe se Serbia ka marrë vendim për dorëzimin e tij.

# 2.

## Publikimet në gjuhën serbe

Në bazë të gjetjeve dhe trajtimin e 69 përmbajtjeve keqinformuese, 17 (25%) prej tyre ishin në gjuhën serbe. Pjesa më e madhe e përmbajtjeve në gjuhën serbe janë publikuar në media reale (16%) ndërsa 9% e tyre janë publikuar në media sociale. Teoritë konspirative (14%) dhe dezinformatat (6%) janë ato që kanë dominuar gjatë muajit korrik. Sa i përket temave, veriu (10%) dhe rasti i Faton Hajrizit (7%), janë ato që kanë dominuar gjatë muajit korrik në përmbajtjet keqinformuese në gjuhën serbe.




Në bazë të gjetjeve dhe trajtimin e 17 përmbajtjeve keqinformuese gjatë muajit korrik 2024, është evidentuar se teoritë konspirative janë ato që kanë dominuar si kategori kryesore e keqinformimit me 14%. Kjo kategori pasohet nga dezinformatat me 6%.

Teoritë konspirative kryesisht përqendrohen në temat si: pretendimet se mbishkrimet “UÇK” dhe “Faton Hajrizi” janë bërë nga “ekstremistët shqiptarë” si kërcënim për dëbim të serbëve; Thirrja për dorëzim të dokumentacionit të vilave në Ujman paraqitet si tentim i grabitjes së pronave të serbëve; Mediumi në gjuhën serbe konspiron mbi shpërthimin në Ujman; "Pretendohet pa fakte se serbët e Kosovës do të sanksionohen për shkak të bojkotimit të regjistrimit të popullsisë"; Aksioni i AKP-së në veri paraqitet pa fakte si “vazhdim i terrorit të Kurtit” ; Konspiracion se djegia e flamurit serb në Mitrovicë të Veriut paraqet mbjellje frike për serbët nga ana Kurtit; Presidenti serb pa fakte pretendon se Kosova i ngriti “Bayraktarët” për t’i zbuluar pozicionet e ushtrisë serbe; Ndalimi i të miturve serbë për ngjitjen e afisheve në veri paraqitet pa fakte si synim i dëbimit të rinisë serbe; Djegia e dy kamionëve dhe një veture udhëtarësh në Veri, pretendohet pa fakte se është truk nga Policia Kosovës.

Dezinformatat janë vlerësuar përmbajtjet keqinformuese me temat si: Krahasim dezinformues nga Lavrov rreth aneksimit të Krimesë dhe pavarësisë së Kosovës Petkoviç pretendon rrejshëm se “Kurti e Prishtina” kanë anuluar ngjarjet zyrtare në shenjë zie e nderimi për Faton Hajrizin; Mediumi në gjuhën serbe pretendon pabazë se Kurti dërgoi një terrorist për të krijuar kaos në Serbi ; Pamjet nuk paraqesin pjesëtarë të FSK-së në Mitrovicën e Veriut, videoja është e vjetër e realizuar në Mitrovicën e Jugut.

## KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave




Gjatë muajit korrik 2024, temat kryesore të përmbajtjeve keqinformuese të publikuara në gjuhën serbe përfshinin kryesisht çështje të ndërlidhura me Serbinë dhe veriun e Kosovës. Sipas analizave, 25% e përmbajtjeve të publikuara trajtonin çështje të lidhura me Serbinë, ndërsa veriu i Kosovës përbënte 10% të temave të trajtuara, duke përfshirë aksionet dhe situatat në këtë rajon. Rasti i Faton Hajrizit gjithashtu ishte një temë e rëndësishme, duke zënë 6% të totalit, me përmbajtje që shpesh përhapnin dezinformata lidhur me ngjarjet rreth vrasjes së tij.

Tema të tjera që u trajtuan përfshinin thirrjet "Kosova është Serbi" (1%), lidhjet mes Krimesë dhe Kosovës (1%), dronët Bayraktar (1%), regjistrimin e popullsisë (1%), si dhe pensionet dhe vendbanimet me shumicë serbe (1%). Po ashtu, përmbajtje keqinformuese kishte edhe për çështje ndërkombëtare si Olimpiada 2024 (1%), masakra e Reçakut (1%), Srebrenica (1%) dhe materiale të tjera të ndërlidhura me çështjet e sigurisë dhe politikës rajonale.


## FUSHAT KRYESORE

Këtu janë renditur 6-të fushat kryesore




Gjatë muajit korrik 2024, fusha e sigurisë dominoi përmbajtjet keqinformuese në gjuhën serbe, duke zënë 14% të të gjitha publikimeve. Pas saj vinin temat sociale me 4%, Sundimi i ligjit dhe politika gjithashtu ishin tema të spikatura, secila me 3%, ku përfshiheshin spekulime dhe dezinformata lidhur me aksione policore dhe zhvillime politike në Kosovë. Fusha të tjera të trajtuara, megjithëse në shkallë më të ulët, përfshinin sportin dhe kronikën e zezë, secila me nga 1%.

DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES TË PUBLIKUESVE ME PËRMBAJTJE KEQINFORMUESE




PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË MEDIAT SOCIALE




Gjatë muajit korrik 2024, përmbajtjet keqinformuese në gjuhën serbe u publikuan kryesisht në media tradicionale, duke zënë 16% të rasteve, ndërsa një pjesë e konsiderueshme prej 9% u publikua në media sociale. Telegrami dominoi me 4% të përmbajtjeve keqinformuese, duke u shfaqur si një platformë kryesore për shpërndarjen e dezinformatave. Facebook dhe TikTok kontribuuan me nga 1% secila, duke vazhduar të jenë burime të përhapjes së keqinformimit. Po ashtu, platforma X (ish-Twitter) gjithashtu përbënte 1% të përmbajtjeve, duke treguar se këto platforma mbeten terrene të rëndësishme për përhapjen e informacioneve të pasakta.

RENDITJA E INSTITUCIONEVE MË TË PËRËFOLURA SIPAS PËRQINDJES



RENDITJA E PERSONAVE MË TË PËRËFOLUR SIPAS PËRQINDJES



Nga 17 keqinformata të identifikuara gjatë muajit korrik 2024, në 6 prej tyre janë përmendur institucione të rëndësishme. Policia e Kosovës dhe Zyra për Kosovën në Qeverinë serbe ishin më të përmendurat, secila në 2 raste (3%). Po ashtu, Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) u përmendën secila në nga 1 rast (1%).

Në teoritë konspirative të publikuara gjatë muajit korrik 2024, Zyra për Kosovën në Qeverinë serbe u përmend në kontekst të disa temave. Pretendohet pa fakte se mbishkrimet “UÇK” dhe “Faton Hajrizi” janë bërë nga “ekstremistët shqiptarë” si një kërcënim për dëbimin e serbëve. Po ashtu, u pretendua pa bazë se rrahja e një qytetari serb në Bërnice ndodhi “për motive etnike, si pasojë e politikës antiserbe të Kurtit.”

Policia e Kosovës u përfol në disa teori konspirative gjatë korrikut 2024, të cilat synonin të manipulojnë opinionin publik dhe të nxisin tensione etnike. Njëra nga këto teori pretendonte pa fakte se ndalimi i të miturve serbë për ngjitjen e afisheve në veri ishte një synim i qëllimshëm për të dëbuar rininë serbe nga rajoni. Një tjetër teori konspirative sugjeronte pa prova se djegia e dy kamionëve dhe një veture në Veri ishte një truk i organizuar nga Policia e Kosovës, duke e paraqitur situatën si një veprim të qëllimshëm për të frikësuar serbët.

Gjatë muajit korrik 2024, personalitetet më të përmendura në përmbajtjet keqinformuese ishin kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, me 6% të rasteve në 4 përmbajtje të ndryshme. Ai u përmend në kombinim me çështje të ndryshme politike dhe të sigurisë. Faton Hajrizi u përmend gjithashtu disa herë, shpesh i lidhur me Albin Kurtin dhe raste të tjera (1%). Ndërkohë, presidenti serb Aleksandër Vuçiq, ministri i Jashtëm rus Sergey Lavrov, dhe figura të tjera si Rodri dhe Petar Petković u përmendën në 1% të përmbajtjeve secili, duke reflektuar ndikimin e tyre në diskursin publik përmes keqinformimit.

Albin Kurti u përfol në disa teori konspirative të publikuara gjatë korrikut 2024, të cilat synonin ta portretizojnë atë në mënyrë negative. Një medium serb konspironte mbi shpërthimin në Ujman, duke e ndërlidhur ngjarjen me qëndrimin e Kurtit ndaj serbëve. Po ashtu, pretendohet pa fakte se serbët e Kosovës do të sanksionoheshin për shkak të bojkotimit të regjistrimit të popullsisë. Aksioni i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) në veri paraqitej si “vazhdim i terrorit të Kurtit,” dhe një tjetër teori sugjeronte se djegia e flamurit serb në Mitrovicë të Veriut ishte një mënyrë për të mbjellë frikë te serbët nga ana e tij.

# 3.

## Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave

Hibrid.info, përveç kontrollit dhe analizës së artikujve mediatik, bën edhe kontrollin dhe vlerësimin e deklaratave të zyrtarëve të lartë politikë e institucionalë, si dhe figurave që kanë ndikim publik. Vlerësimi i këtyre figurave, sipas metodologjisë së hibrid.info, bëhet në kategoritë e vërtetësisë, qëndrueshmërisë dhe përmbajtjes së premtimeve.



Në kuadër të përmbajtjes së monitoruar gjatë muajit korrik, hibrid.info ka kontrolluar dhe analizuar 3 premtime dhe deklarata.

160 çerdhe të reja në të gjithë vendin, kishte premtuar Lëvizja Vetëvendosje (LVV), gjatë fushatës zgjedhore të zgjedhjeve të jashtëzakonshme të 14 shkurtit, në vitin 2021. Albin Kurti, kandidat për kryeministër nga LVV, në hapjen e fushatës së këtij subjekti (2 shkurt), kishte shpalosur programin qeverisës dhe listën e kandidatëve për deputetë, ku në mesin zotimeve kishte përmendur edhe këtë për çerdhe të reja. Numri i 160 çerdheve të cilat ishin premtuar në fillim të mandatit, nga Lëvizja Vetëvendosje, për më shumë se tre vjet e gjysmë, nuk është përmbushur.

Nëpërmjet disa deklaratash e postimesh, ministri i Bujqësisë, Faton Peci ka thënë se Kosova ka përmbushur nevojat e veta për bukën e motmotit. Ai ka përmendur shifra e statistika, që pas verifikimit të fakteve, demantohen nga dokumente të Agjencisë së Statistikave dhe të vetë Ministrisë që Peci e udhëheq. Përderisa ministri ka thënë se Kosova sivjet (2024) ka prodhuar 300 mijë tonë grurë dhe rreth 150 mijë më



shumë se vitin e kaluar (2023), të dhënat zyrtare nga viti i kaluar nxjerrin kalkulime tjera. Sipas dokumenteve, edhe vitin e kaluar ishin prodhuar më shumë se 300 mijë tonë grurë. Ai po ashtu ka thënë se sipërfaqja e mbjellë me grurë është rritur për 60 për qind prej marrjes së mandatit, por të dhënat e demantojnë edhe këtë. Më 2021 kur erdhi Peci në pushtet, në Kosovë ishin mbjellë rreth 80 mijë hektarë, aq sa ishin edhe vitin e shkuar. Ministri ka thënë se sivjet s'ka nevojë për import të grurit. Por të dhënat tregojnë se Kosova në disa raste ka prodhuar më shumë grurë se pretendimi i ministrit për sivjet dhe se as atëherë nuk i ka përmbushur nevojat e veta për konsum dhe është varur nga importi.

Lëvizja Vetëvendosje (LVV) kishte premtuar banim të përbalueshëm për 4 mijë familje, në fushatën zgjedhore të zgjedhjeve të jashtëzakonshme të 14 shkurtit, në vitin 2021. Sigurimin e asaj që ky subjekt e quante "Banimi i përbalueshëm" e kishte premtuar kandidati për kryeministër nga LVV, Albin Kurti, në hapjen e fushatës së këtij subjekti politik (2 shkurt). Në më shumë se tre vjet qeverisje, premtimi për sigurimin e banimit të përbalueshëm për 4 mijë familje, nuk është realizuar.

# Metodologjia

---

Për hartimin e këtij raporti monitorues janë përdorur metodat kuantitative dhe ato kualitative.

Sa i përket metodave kuantitative, fillimisht është krijuar baza e të dhënave nga ADS/hibrid.info me qëllim të zbërthimit dhe analizimit të detajuar të trendëve të keqinformimit. Përmes kësaj baze të të dhënave, e cila mirëmbahet dhe përditësohet në baza të rregullta ditore nga stafi i ADS/hibrid.info, monitorohen rregullisht artikujt me përmbajtje keqinformuese.

Kjo nënkupton se të gjithë artikujt e publikuar në platformën hibrid.info vendosen në bazën e të dhënave dhe kjo e fundit shërben si një ndër burimet kryesore për përgatitjen e raportit monitorues. Për më tepër, metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave të paraqitura në raportin monitorues bën të mundur filtrimin e të dhënave në baza ditore, javore e mujore, dhe atë në formë kryesisht kuantitative, për të kuptuar më qartë fenomenin e keqinformimit të atyre artikujve të analizuar për këtë periudhë monitoruese një mujore sipas kategorive e vlerësimeve të ndryshme.

Krahas kësaj, një burim tjetër i rëndësishëm për këtë raport është metodologjia e ADS/hibrid.info (e publikuar në faqen e hibrid.info) për luftën kundër çrregullimit informativ. Metodologjia, e cila është e bazuar para së gjithash në metodat kualitative, është hartuar nga stafi profesional i ADS/hibrid.info dhe është në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare për kontroll të fakteve, gjegjësisht sipas udhëzimeve të Rrjetit Ndërkombëtar për Kontroll të Fakteve (IFCN). ADS/hibrid.info është anëtarë me të drejta të plota në këtë mekanizëm ndërkombëtar - IFCN.

Ky raport monitorues përfshin periudhën nga 1 deri më 31 korrik 2024, në të cilën janë trajtuar 69 përmbajtje keqinformuese.

---

Ky raport i shkurtër monitorues paraqet një pasqyrë të gjendjes një mujore të informimit (keqinformimit) gjatë muajit korrik 2024, nga të dhënat e platformës për kontroll të fakteve – hibrid.info.

---

Gjatë muajit korrik 2024, një analizë e 69 përmbajtjeve keqinformuese ka zbuluar se 71% e tyre ishin në gjuhën shqipe, me gati gjysmën (46%) të publikuara në media sociale. Kategoritë më të zakonshme të keqinformimit përfshijnë mashtrimet (17%), artikujt clickbait (19%), dhe dezinformatat (9%). Temat kryesore përfshijnë rasti i Faton Hajrizit (7%) dhe zgjedhjet në Kosovë (6%), të cilat kanë nxitur një interes të lartë në publik, duke reflektuar në një rritje të përhapjes së informacioneve të pasakta, sidomos në fushat sociale (26%) dhe politike (20%).

---

Përmbajtjet keqinformuese shpesh përhapen përmes platformave sociale, me Facebook si burimi kryesor (28%). Në këtë kontekst, shumë nga përmbajtjet e analizuar janë klasifikuar si teori konspirative (6%) dhe lajme të rreme (6%), duke treguar se keqinformimi jo vetëm që ka një ndikim të rëndësishëm në shoqëri, por gjithashtu ndihmon në formësimin e perceptimeve dhe opinionit publik.

---

Në muajin korrik 2024, janë trajtuar 69 përmbajtje keqinformuese, prej të cilave 17 (25%) ishin në gjuhën serbe. Shumica e këtyre përmbajtjeve janë publikuar në media tradicionale (16%), ndërsa 9% janë shfaqur në media sociale. Teoritë konspirative (14%) dhe dezinformatat (6%) ishin kategoritë më të përhapura. Temat kryesore që janë trajtuar përfshinin veriun e Kosovës (10%) dhe rastin e Faton Hajrizit (7%).

---

Në analizën e përmbajtjeve keqinformuese, u vërejt se teoritë konspirative ishin dominueset, me tema si pretendimet për mbishkrimet “UÇK” dhe “Faton Hajrizi”, si dhe aludime për grabitje të pronave të serbëve. Dezinformatat përfshinin krahasime rreth Krimesë dhe Kosovës dhe pretendime të pavërteta mbi veprimet e qeverisë kosovare. Kategoritë e publikimeve ishin të ndara kryesisht në media tradicionale, me Telegramin si platformën kryesore për shpërndarjen e keqinformimit.

HIBRIDO.INFO